



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË
KORÇË

VENDIM
Nr 80 Datë 18.09.08

PER

Miratimin e shpenzimeve të personelit për institucionin e Menaxhimit të
Projekteve (PIU)

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Finances 'Miratimin e shpenzimeve të personelit për institucionin e Menaxhimit të Projekteve (PIU) bazuar në ligjin nr. Mbi 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, ligjin nr.9836 dt. 26.11.2007 « Per buxhetin e Shtetit te vitit 2008 », Udhezimin nr.4 dt.17.01.08 i M.F « Per zbatimine buxhetit te shtetit per vitin 2008 ».Udhezimin nr 258 dt. 15.02.2008 i Ministrise se Brendshme « Per zbatimin e buxhetit te qeverisjes vendore per vitin 2008 », V.K.B nr. 12 dt. 18.03.2008 « miratimin e buxhetit te Bashkise dhe institucioneve te vartesis per vitin 2008 », Ligji nr. 9936 date 26.06.2008 « Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise » mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1.Të miratoje shpenzimet e personelit per institucionin e Menaxhimit te Projekteve (PIU) me vleren 277,157 lekë.

2. Shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime shoqerore) nga data 15.09.2008 deri me 31.12.2008 do të përballohet nga fondi i planifikuar i pagave te administrates se Bashkise ne buxhetin e vitit 2008 me kete strukture buxhetore :

Pakësohet Bashkia	00	01110	05	Art	6000000	- 229 688
Pakësohet Bashkia	00	01110	05	Art	6010000	- 47 469
Shtohet Inst. PIU	00	01110	05	Art	6000000	+ 229 688
Shtohet Inst. PIU	00	01110	05	Art	6010000	+ 47 469

4.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës.

5.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Kryetari
Raimonda Nase
Raimonda Nase